VENDIM
Nr.744, datë 9.11.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.37, DATË 28.1.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E REPARTIT TË INSPEKTIM-SHPËTIM-MINIERA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14 të ligjit nr.8741, datë 15.2.2001 "Për sigurinë në punë, në veprimtarinë minerare", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 10 e vendimit nr.37, datë 28.2.2002 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"10. Struktura organizative e repartit të inspektim-shpëtim-miniera (RISHM) të jetë sipas pasqyrës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.".

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha